



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.42/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesëmarjen e zyrtares ligjore Arjeta Syla, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes se posterave të kandidatëve në hapësira publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 25.09.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratit të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i shqiptohet dënim i më gjybë në vlerë prej 600.00 (gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

#### A r s y e t i m

Me datën 22.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se me datën 22.09.2017, në rrugën “Dëshmoret e Kombit” në Ferizaj, monitoruesi ynë ka hasur në poster të kandidatëve për këshilltar komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës, të ngjitur në hapsira publike dhe atë në hyrje të postes së qytetit.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1, pika b), të LPZ-së Ligji Nr. 03/L-073 duke pretenduar se subjekti në fjalë ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur posterin në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 23.09.2017, subjekti politik LDK thekson se ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) është e pabazë, sepse në kushte në të cilat është duke u zhvilluar fushata zgjedhore, duke pasur parasysh faktin se komunat nuk kanë arritur që, ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore, të krijojnë hapsira të veçanta për vendosjen e materialëve zgjedhore, vendosja në një shtyllë elektrike nuk do duhej të trajtohet si shkelje.

Gjithashtu, ka theksuar se ka ndërmarr masat e duhura dhe ka evituar “shkeljen” e pretenduar nga kandidatja në fjalë.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur një fotografi ku shihet se është larguar posteri nga vendi ku ka qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal të subjektit politik LDK-së, është vendosur në hapsira publike përkatësisht në hyrje të postes së qytetit, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakave, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal të subjektit politik LDK-së, janë vendosur në hyrje të postes së qytetit.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike Lidhja Demokratike e Kosovës ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti posterat e këtij subjekti politik janë vendosur në hapsira publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime përfshirë përmirësimin e shkeljes, ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr.42/2017 më datën 25.09.2017.



**Kryesuesi i Panelit**

Gyltene Sylejmani

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.